




REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

## Njoftim për shtyp.

2017-06-24 14:20:00



Në vijim të masave operacionale, të parashikuara për garantimin e zgjedhjeve, Ministria e Zhvillimit Urban fton të gjithë qytetarët të denoncojnë në e-maillet, telefonat apo rubriken e denocimeve të Ministrisë, çdo rast të përfshirjes së punonjësve të kësaj ministrie dhe/ose institucioneve tona të varësisë në shitblerje të votave, ndikimit të votuesve për të votuar për një subjekt të caktuar politik apo shkelje të tjera të lidhura me zgjedhjet.

Ministria e Zhvillimit Urban shpreh angazhimin e saj maksimal dhe vendosmërinë për të marrë të gjitha masat e nevojshme për të kontribuar në një proces zgjedhor të lirë dhe të ndershëm, ku çdo qytetar dhe punonjës të jetë i lirë të shprehë vullnetin e tij në procesin e votimit.

MZHU ve në dispozicion të qytetarëve adresën e e-mail-it:

[info@zhvillimiurban.gov.al](mailto:info@zhvillimiurban.gov.al) si dhe numrin e telefonit: 0696834344